




**NJIHUNI ME
BANKËN POPULLORE
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Banka Popullore e Republikës së
Maqedonisë së Veriut është BANKA
QENDRORE e vendit tonë.

Banka Popullore është e PAVARUR
në arritjen e qëllimeve dhe detyrave
të përcaktuara me Ligjin për Bankën
Popullore.

- Banka qendrore sipas funksioneve dallon nga bankat komerciale.
- Banka qendrore ka funksione të veçanta të përcaktuara me ligj.
- Banka qendrore, me instrumentet dhe masat e saj, vepron mbi bankat komerciale në vend, ndërsa bankat komerciale janë në kontakt të drejtpërdrejtë me sektorin privat - popullatën dhe firmat.



A E DINI SE...



...veprintaria e bankës qendrorenë territorin e vendit tonë daton që nga viti 1946.

Qëllimi kryesor i Bankës Popullore
është arritja dhe ruajtja e
STABILITETIT TË ÇMIMEVE në
vend.

Banka Popullore kujdeset për stabilitetin e çmimeve duke mbajtur inflacionin në një nivel të arsyeshëm dhe pa shumë luhajtje. Norma e inflacionit reflekton ndryshimet e çmimeve në ekonomi. Inflacioni i lartë do të thotë rritje e lartë e çmimeve në ekonomi (dhe anasjelltas), gjë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në kushtet e jetesës. Inflacioni është një faktor i rëndësishëm për investime, gjegjësisht ambienti që karakterizohet me stabilitet të çmimeve është më i favorshëm për nxitjen e investimeve dhe rritjes ekonomike.



A E DINI SE...



**...në periudhën prej vitit 1996 deri në vitin 2018
norma mesatare e inflacionit është rreth 2%.**

Si qëllim tjetër i Bankës Popullore, në varësi të qëllimit kryesor është ruajtja e STABILITETIT FINANCIAR.

Banka Popullore rregullon, jep leje dhe kryen MBIKËQYRJE të bankave, shtëpive të kursimit, shoqatave për emetim të parave elektronike dhe institucioneve tjera financiare (zyra të autorizuar të këmbimit valutor, ofrues të shërbimeve transfer i shpejtë i parave dhe sub-agjentëve të tyre).

Banka Popullore është institucion rregulator i sistemit bankar, që do të thotë se është kompetente për mbikëqyrje dhe vëzhgim të punës së bankave komerciale. Sistemi i qëndrueshëm bankar është parakusht për një ekonomi të qëndrueshme dhe përparimtare. Bankat janë institucionet kryesore në sistemin financiar të vendit tonë.



A E DINI SE...



...në fund të vitit 2018, sistemin bankar në vendin tonë e përbëjnë 15 banka komerciale. Numri i njëjësive komerciale të bankave nëpër gjithë vendin është 420.

Banka Popullore përcakton dhe
zbaton POLITIKËN MONETARE.

Politika monetare zbatohet përmes aplikimit të instrumenteve monetare në dispozicion. Instrumentet monetare kanë ndikimin e duhur mbi bankat, të cilat, nga ana tjetër kanë ndikim mbi sektorin privat - kompanitë dhe popullatën.



A E DINI SE...



...instrumenti themelor i Bankës Popullore janë ankandet e bonove të bankës qendrore dhe norma e tyre e interesit është norma bazë e Bankës Popullore. Një herë në muaj, Banka Popullore vendos mbi nivelin e normës bazë të interesit në mbledhjet e rregullta mujore të Komitetit për Politikë Operative Monetare.

Banka Popullore e përcakton dhe zbaton POLITIKËN E KURSIT TË KËMBIMIT VALUTOR dhe merr pjesë në përcaktimin e REGJIMIT TË KURSIT TË KËMBIMIT VALUTOR.

Që nga viti 1995 këtej, është mbajtur një kurs i qëndrueshëm i këmbimit të denarit, në fillim në raport me markën gjermane, dhe pas formimit të euro zonës në raport me euron.

Në një ekonomi të vogël dhe të hapur, ku pjesëmarrja e mallrave të importuara është e konsiderueshme, sidomos nga euro zonë që është partneri ynë më i rëndësishëm tregtar, kursi stabil i këmbimit valutor luan një rol të rëndësishëm për stabilizimin e pritjeve të çmimeve dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.



A E DINI SE...



Strategjia për politikën monetare

➤ nga prilli i vitit 1992 deri në shtator të vitit 1995:
Strategjia e shënjestrimit monetar

➤ nga tetori i vitit 1995 këtej:

Strategjia e shënjestrimit të kursit nominal të këmbimit
(Deri në vitin 2002 në raport me markën gjermane - DM,
dhe nga viti 2002 këtej, në raport me euron - €)

Banka Popullore ka të drejtën
ekskluzive për shtypje, emetim dhe
menaxhim me KARTËMONEDHAT
DHE MONEDHAT në vendin tonë.

Denari u prezantua me pavarësimin monetar, më 26 prill të vitit 1992, si mjet ligjor për pagesa në vendin tonë.



A E DINI SE...



... emri i valutës - denar rrjedh nga emërtimi i lashtë romak „denar“ (lat. Denarius) që është përdorur në këto hapësira në të kaluarën.

... kartëmonedhat e para me përbërje plastike-polimer me vlerë nominale 10 denarë dhe 50 denarë i emtoi Banka Popullore dhe u lëshuan në qarkullim më 15 maj të vitit 2018.

Banka Popullore ruan dhe
menaxhon REZERVAT VALUTORE
të shtetit.

Banka Popullore menaxhon rezervat valutore të vendit, duke u kujdesur për ruajtjen e likuiditetit në vend gjatë kryerjes së pagesave jashtë vendit.



A E DINI SE...



...në fund të vitit 2003, rezervat valutore zyrtareishin 715 milionë euro, dhe në fund të vitit 2018 ishin 2.867 milionë euro.

Banka Popullore krijon, zhvillon,
regjistron dhe kryen mbikëqyrje
mbi sigurinë, stabilitetin dhe
efikasitetin e SISTEMEVE PËR
PAGESA, SHLYERJE DHE
KLIRING.

Banka Popullore siguron një pjesë të infrastrukturës për kryerjen e pagesave në vendin tonë dhe luan një rol të rëndësishëm mbikëqyrës në sistemin maqedonas të pagesave. Sistemi i pagesave është „sistemi i qarkullimi të gjakut“ i ekonomisë, i cili siguron rrjedhën e parave.






A E DINI SE...



... Banka Popullore është operator i sistemit ndërbankar të pagesave, përmes të cilit shlyhen pagesat e mëdha ndërmjet bankave.

Banka Popullore grumbullon dhe
përpilon TË DHËNA
STATISTIKORE për kryerjen e
detyrave të saj në pajtim me
ligjin.

Banka Popullore është institucion i cili është përgjegjës për grumbullimin dhe publikimin e të dhënave nga fusha e statistikës monetare dhe statistikës së jashtme – të dhëna për: agregatin monetar, depozitat dhe kreditë bankare, normat bankare të interesit, bilancin e pagesave, borxhin e jashtëm etj.




A E DINI SE...



... të dhënat statistikore publikohen në bazë të një kalendari të përcaktuar paraprakisht, dhe për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore mund të drejtoheni në adresën elektronike contact.statistika@nbrm.mk

Banka Popullore kryen
aktivitete të shumta në fushën
e Edukimit Financiar dhe
Përfshirjes Finaciare.

Në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2018, në kuadër të aktiviteteve për edukim financiar, Bankën Popullore e kanë vizituar rreth 9.000 nxënës nga shkollat fillore dhe të mesme dhe studentë nga fakultetet e shtetit.



A E DINI SE...



...ekziston një adresë e posaçme elektronike: edukacija@nbrm.mk në të cilën shkollat dhe fakultetet mund të dërgojnë kërkesë për vizitë dhe ligjërata në Bankën Popullore.

Në materialet edukative të Bankës popullore përpunohen më shumë aspekte nga sfera ekonomike: banka qendrore, roli dhe funksionet e saj, institucionet kryesore financiare, termet ekonomike, kursimi, produkte financiare si dhe mbrojtja e përdoruesve të shërbimeve financiare.

Banka popullore në faqen e saj të internetit në fushën e Edukimit Financiar ka publikuar materiale të shumta për grupmosha të ndryshme.



Muzeu i Bankës Popullore posedon një koleksion të pasur numizmatik.

Fillimet e Muzeut të Bankës Popullore datojnë që nga viti 1999. Gjatë ekzistencës së tij, koleksioni numizmatik vazhdimisht është pasuruar, dhe sot me rreth 22,000 shembuj, është koleksioni më i rëndësishëm publik në vend.

Ekspozita e muzeut është e hapur për publikun çdo ditë pune prej orës 9 deri në orën 15. Adresa elektronike për rezervimin e vizitave: muzej@nbrm.mk.



Shkronja M e parave bizantine paraqet numrin 40.

Kjo monedhë shfaqet në kartëmonedhat tona prej 50 denarësh.

A E DINI SE...



... pikërisht kjo monedhë përdoret si logo e Bankës Popullore.



Ju dhe Banka Popullore...

Banka Popullore ndan Çmimin e Vitit për Hulumtues të Rinj për punimin më të mirë kërkimor në fushën e makroekonomisë dhe sistemit bankar. Më shumë informacione në:

www.nbrm.mk > Reth bankës popullore > Çmimi i vitit

Banka Popullore në bazë tremujore mban sesione të rregullta të Klubit të Hulumtuesve, në të cilët prezantohen punime kërkimore. Klubi është i hapur edhe për persona nga jashtë. Më shumë informacione:

www.nbrm.mk > Shtepi > Botime > Hulumtime > Klubi i hulumtuesve

Banka Popullore ka publikuar më shumë materiale nga fusha të ndryshme të veprimtarisë së saj. Më shumë informacione në:

www.nbrm.mk > Shtepi > Botime > Hulumtime

Banka Popullore, bashkë me institucionet tjera financiare rregulluese, rregullisht shpall konkurs për krijime artistike dhe letrare për nxënës të arsimit fillor dhe të mesëm me rastin e Ditës Botërore të Kursimit - 31 Tetor. Më shumë informacione në:

www.nbrm.mk > Shtepi > Edukim financiar > Konkurse

Banka Popullore ka Bibliotekë dhe Arkiv. Biblioteka posedon një fond të pasur bibliotekar nga fusha e ekonomisë. Adresa elektronike: **biblioteka@nbrm.mk**. Arkivi posedon materiale të digjitalizuara arkivore me rëndësi historike për veprimtarinë e bankës qendrore në territorin e vendit tonë. Adresa elektronike: **arhiv@nbrm.mk**

Për të gjithë pyetjet rreth veprimtarisë, ju mund të drejtoheni në: **info@nbrm.mk**

Ndiqu veprimtarinë e Bankës Popullore në internet faqen **www.nbrm.mk** dhe rrjetet sociale:



Botues: BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Redaktorët e botimit: Aneta Krstevska dhe Kristina Pavleska

Tekst: Aneta Krstevska, Kristina Pavleska dhe Olivera Panovska

Ilustrim dhe dizajn: Kristina Pavleska, Olivera Panovska dhe Leudita Musa

Bashkëpunëtorë: Jovica Mitiq dhe Ivan Antonovski

Përktheu dhe lektori: Arian Limani

Copyright: © 2019 Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nuk lejohet kopjim dhe shumëfishim i këtij materiali.

Për përdorim të të dhënave nga ky botim nevojitet të citohet burimi.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Bul. „Kuzman Josifovski - Pitu“ nr. 1, 1000



Shkup Telefon: (02) 3108 108



<http://www.nbrm.mk>